



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:163941

Datë: 08.10.2024

Numri i dokumentit: 06268842

**K.DH.SH.II.nr.966/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Franciska Zhitija – Ymeri dhe Krenar Berisha, anëtarë të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Klan Kosova” ShPK me seli në Zonën Industriale, ish-Fabrika e Amortizatorëve, Prishtinë, me numër unik identifikues 810795297, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “Sejdiu&Qerkini, me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë-Agjencia për Pronësi Industriale, te cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.315/23 të datës 21.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 08.10.2024, merr këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**Refuzohet** si e pa bazuar ankesa të paditurit Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës- Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.315/23 të datës 13.13.2024, **Vërtetohet**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin KA.nr.385/22 të datës 13.10.2023 ka vendosur, në pikën I. Aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Klan Kosova” ShPK, Anulohen vendimi nr. 4566/01 i datës 28.07.2023 i nxjerrë nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave për Regjistrimin e Bizneseve dhe vendimi nr.309/11 i datës 14.06.2023 i nxjerrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë pranë të paditurit Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Nën pikën II. Ky aktgjykim i zëvendëson aktet e anuluar dhe ka karakter detyrues. Nën pikën III. Shtyrja e ekzekutimit të vendimit nr. 4566/01 të datës 28.07.2023 i nxjerrë nga Komisioni për Shqyrtimin e

Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve dhe Vendimi nr. 309/11 të datës 14.06.2023 i vendimi nr. 309/11 të datës 14.06.2023 i nxjerrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, sipas Aktvendimit të kësaj gjykate KA.nr.315/23 i datës 02.08.2023, mbetet në fuqi deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi. Nën pikën II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka parashtruar ankesë e paditura përmes përfaqësueses së autorizuar Avokatura Shtetërore për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurës-Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në Prishtinë, të prishet aktgjykimi KA.nr.315/23 i datës 13.03.2024 i Gjykatës Komerciale në Prishtinë-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative. Të refuzohet në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit “Klan Kosova” ShPK me seli në Zonën Industriale, ish Fabrika e Amortizatorëve-Prishtinë. Dhe të mbetet në fuqi vendimi nr.4566/01 i datës 28.07.2023 i nxjerr nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve si dhe vendimi nr.309/11 i datës 14.06.2023 i nxjerrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë.

Paditësi ka paraqitur përgjigje në ankesë me datë 11.04.2024, në të cilën ka kundërshtuar ankesën e të paditurës dhe tri elementet e paraqitura në të njëjtën bashkë me arsyetimin e dhënë, pasi që e njëjta nuk ka prezantuar asnjë rrethanë të re e cila do të provonte të drejtën subjektive të tij, rrjedhimisht me asnjë element të paraqitur në ankesë nuk e ka bërë të besueshme dhe të argumentuar se Aktgjykimi i Shkallës së Parë nuk është në përputhje me dispozitat e procedurës kontestimore, gjendjes faktike dhe aplikimit të së drejtës materiale. Andaj ka propozuar që të refuzohet në tërësi ankesa e të paditurës Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë e datës 02.04.2024 si e pa themeltë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale në Prishtinë-Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm KA.nr.315/2024 i datës 13.03.2024 të vërtetohet.

Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA, nenit 81.H të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative ( LKA ), gjeti se:

### **Ankesa është e pa bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin nr.protokoli vendimi nr.4566/01 të datës 28.07.2023, të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë-Komisionit për Shqyrtimin e ankesave për Regjistrimin e Bizneseve, nën pikën I. të dispozitivit ka vendosur, Refuzohet ankesa e parashtruar nga Shoqëria Tregtare “Klan Kosova” ShPK me seli në Prishtinë adresa në Zonën Industriale, ish Fabrika e Amortizatorëve. Nën pikën II, mbetet në fuqi vendimi i

ARBK-së me numër 309/11 i datës 14.06.2023 i lënë në fuqi me vendimin numër 336 të datës 21.06.2023.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e të paditurës ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datë 31.07.2023 me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i pa paligjshëm.

Dhoma e Shkallës së Parë pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit të paditurës dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar duke anuluar vendimin nr. 4566/01 i datës 28.07.2023 i nxjerrë nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave për Regjistrimin e Bizneseve dhe vendimi nr.309/11 i datës 14.06.2023 i nxjerrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë pranë të paditurit Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Në arsyetim ndër tjera ka theksuar se: Gjykata vlerëson se nga provat e administruara ka rezultuar se i padituri në procedurë administrative ka bërë zbatim të gabuar të dispozitave ligjore, përkatësisht nuk ka aplikuar drejtë dispozitat ligjore të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA) dhe Ligjit nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, gjë që ka rezultuar në nxjerrjen e vendimeve të kundërligjshme nga i padituri në procedurë administrative. Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimeve kontestuese me padi në kuptim të nenit 4 të Ligjit Nr. 05/L -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“1. Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca. 2. Veprimi administrativ që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj ...”* Ky parim përcakton detyrimin e organeve të administratës publike, që gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, të punojnë dhe vendosin në bazë të Kushtetutës, ligjit, në suaza të kompetencave, si dhe në pajtim me qëllimin për të cilin u janë dhënë ato kompetenca. Pra, organet e administratës publike të cilat zhvillojnë procedurën administrative, kur vendosin në çështje administrative mbi të drejtat, detyrimet ose interesat juridike të individëve, të personave juridik dhe palëve tjera duhet t’i përmbahen LPPA-së dhe të zbatojnë drejtë dispozitat materiale juridike, në bazë të cilave vendoset mbi të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të qytetarëve, të personave juridik ose të palëve tjera. Në zbatim të parimit të ligjshmërisë, gjykata fillimisht shqyrtoi kompetencën e ARBK për pezullimin e certifikatës së biznesit të shoqërive tregtare për çfarë ju referua nenit 9 par. 1 të LSHT-së, ndërsa lidhur me kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm të ARBK-së, gjykata ju referua nenit 10 të LSHT-së. Gjykata vlerëson se ARBK përkatësisht Drejtori i Përgjithshëm ka kompetenca drejtuese për rregullimin e procesit të regjistrimit të Shoqërive Tregtare dhe ka për detyrë të bëjë regjistrimin e shoqërive tregtare ndërsa Drejtori i Përgjithshëm i ARBK nuk mund të vendos kërkesa, kushte ose kufizime që nuk janë përcaktuar shprehimisht në LSHT, andaj gjykata konstatoi se Drejtori i Përgjithshëm i ARBK-së nuk ka kompetenca në marrjen e

vendimeve për pezullimin e certifikatave të bizneseve e që për pasojë kanë humbjen e efektit juridik të regjistrimit të paditësit në ARKB, në atë mënyrë që paditësi nuk do të mund të ushtronte as veprimtari ekonomike, kjo në kuptim të nenit 4 të LSHT-së i cili përcakton se: “Veprimtaria Ekonomike në Kosovë mund të ushtrohet vetëm nga Shoqëritë Tregtare të regjistruara në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve, përveç nëse është përcaktuar shprehimisht ndryshe me ligj.” Andaj, lidhur me këtë, gjykata gjeti se i padituri gabimisht ka aplikuar dispozitat e LSHT duke pezulluar në mënyrë arbitrare certifikatën e biznesit të paditësit “Klan Kosova” kjo për faktin se drejtori i përgjithshëm i ARBK kishte tejkalluar kompetencat me rastin e nxjerrjes së vendimit për pezullimin e certifikatës së biznesit të paditësit, pasi që paditësi i janë vendosur kushte apo kufizime të cilat nuk gjejnë mbështetje ligjore në Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe nuk ka paraparë dispozita ligjore të cilat i lë në diskrecion drejtorit të ARBK, të pezulloj certifikatën e bizneseve të regjistruara. Gjykata po ashtu iu referua dispozitave ligjore të cilat parashohin shuarjen e personit juridik përmes inicimit të procedurës së falimentimit, në përputhje me nenin 18 të Ligjit Nr. 05/L-083 për Falimentimin (LPF), gjykata konstatoi se ligjet e aplikueshme në Kosovë, si forma të dhunshme të pushimit të veprimtarisë ekonomike të një shoqërie tregtare kanë përcaktuar likuidimin sipas një kërkesë jo vullnetare sipas Ligjit për Falimentimin dhe shqiptimi i dënimit - pushimi i personit juridik sipas Ligjit për Përgjegjësinë e Personave Juridik për Vepra Penale, andaj gjykata gjeti se në rastin konkret nuk janë plotësuar asnjë nga kushtet ligjore, për shuarjen e personit juridik dhe se vendimi kontestues nuk është nxjerrë në asnjërin nga bazat e përcaktuara me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës. Lidhur me pretendimet e të paditurit se paditësi ka cenuar rendin juridik të Republikës së Kosovës, duke paraqitur Komunën e Pejës dhe Komunën e Gjakovës nën administrimin e Republikës së Serbisë, gjykata vlerëson se i padituri me rastin e regjistrimit të ndryshimeve në biznes, ka pasur mundësi që të refuzoj regjistrimin e ndryshimeve në biznes të bëra sipas aplikacionit të datës 31.01.2014 dhe aplikacionit të datës 27.04.2020 ku në të dy rastet është dorëzuar pasaporta e lëshuar nga Republika e Serbisë për pronarët e shoqërisë “KGO Media Investments” LLCSP me seli në Shkup. Në të kundërtën, nëse gabimet e bëra gjatë procedurës së regjistrimit nuk janë vënë re nga ana e të paditurit, i njëjti ka qenë dashur të veproj konform kërkesës për korrigjim, në të cilën paditësi ka bërë përmirësimin e gabimit, në përputhje me nenin 21 par. 2, 3 dhe 4 të LSHT, Po ashtu gjykata konstatoi se në rastet e cenimit të rendin juridik të Republikës së Kosovës nga një person juridik, duhet të veprohet në bazë të Ligjit për Përgjegjësinë e Personave Juridik për Vepra Penale, në bazë të cilit ligj një shoqërie tregtare mund ti shqiptohen sanksionet e përcaktuara me këtë ligj e që përfshinë edhe pushimin e personit juridik në rast të plotësimit të kushteve të përcaktuara në nenin 11 të këtij ligji. Gjykata në kuptim të nenit 52 të LPPA-së, gjeti se Vendimi Nr. 4566/01 i datës 28.07.2023 dhe Vendimi Nr. 309/11 i datës 14.06.2023 të nxjerra nga Agjencia për Regjistrin e Bizneseve në Kosovë, duhet të anulohen pasi që të njëjtat janë nxjerrë në mungesë të kompetencës, në kundërshtim me ligjin material dhe në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit. Prandaj, mbështetur në arsyet e cekura më lartë, gjykata vendosi që të anuloj Vendimin Nr. 4566/01 të datës 28.07.2023 i nxjerrë nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve dhe Vendimin Nr. 309/11 të datës

14.06.2023 i nxjerrë nga Drejtorja e Përgjithshme e Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, mbështetur në nenin 46 par. 4 të LKA-së. Pasi që gjykata aprovoi kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të bazuar, gjykata la në fuqi shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit nr. 4566/01 i datës 28.07.2023 i nxjerrë nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve dhe Vendimit nr. 309/11 i datës 14.06.2023 i nxjerrë nga Drejtorja e Përgjithshme e Agjencisë për Regjistrin e Bizneseve në Kosovë, sipas Aktvendimit të kësaj gjykate KA.nr.315/23 i datës 02.08.2023, deri në plotfuqishmërinë e këtij Aktgjykimi.

Qëndrimin dhe vlerësimin juridik të Dhomës së Shkallës së Parë e pranon si të rregullt dhe të ligjshëm edhe Dhoma e Shkallës së Sytë, për arsye se aktgjykimi i atakuar me ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe 2 pika n), ku përcakton se: *“në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohet, e sidomos në qoftë se dispozitivi është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit – thuhet për përmbajtjen e dokumentit ose procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vetë atyre dokumenteve ose të procesverbalit”* e as nenit 194 të LPK -së, të zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA -së, për të cilat Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare, po ashtu nuk është i përfshirë as në shkeljet e tjera të dispozitave të procedurës administrative e as me konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Pretendimet ankimore se me rastin e vendosjes Gjykata e Shkallës së Parë, nuk mori parasysh se e paditura kishte zbatuar në përpikëri dispozitat ligjore më saktësisht Gjykata me rastin e marrjes së vendimit nuk mori parasysh se e paditura Ministria e Industrisë, Ndërmarrësis dhe Tregtisë (MINT), pas ri verifikimit të dosjes së biznesit “Klan Kosova” ShPK, tani paditëses kishte vërtetuar se e njëjta me rastin e regjistrimit në periudha të ndryshme kohore kishte ofruar dokumentacion i cili në përmbajtje ishte i pasaktë dhe në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare dhe në kundërshtim me parimet themelore të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për shkak se të dhënat e paraqitura në certifikatën e biznesit/përkatësisht të ndërrimit të pronarëve, është paraqitur emri i Komunës Pejë dhe Gjakovë, kurse Shteti Serbia. Kolegji këtë pretendim nuk e aprovoi, pasi vlerësoi se arsyetimi i kundërshtuar është i qartë dhe në përputhje të plotë me elementet e detyrueshme të aktit administrativ të përcaktuara në nenin 47 si dhe me elementet e nevojshme të arsyetimit sipas nenit 48 të LPPA-së. Prandaj për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale, dhe Dhoma e Shkallës së Parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë. Kolegji konstaton se Dhoma e Shkallës së Parë me të drejtë i është referuar nenit Gjykata, shqyrtoi

ligjshmërinë e vendimeve kontestuese me padi në kuptim të nenit 4 të Ligjit Nr. 05/L -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: “1. Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca. 2. Veprimi administrativ që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj ...” Ky parim përcakton detyrimin e organeve të administratës publike, që gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, të punojnë dhe vendosin në bazë të Kushtetutës, ligjit, në suaza të kompetencave, si dhe në pajtim me qëllimin për të cilin u janë dhënë ato kompetenca. Pra, organet e administratës publike të cilat zhvillojnë procedurën administrative, kur vendosin në çështje administrative mbi të drejtat, detyrimet ose interesat juridike të individëve, të personave juridik dhe palëve tjera duhet t’i përmbahen LPPA-së dhe të zbatojnë drejtë dispozitat materiale juridike, në bazë të cilave vendoset mbi të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të qytetarëve, të personave juridik ose të palëve tjera. Po ashtu gjykata ka shqyrtuar kompetencën e ARBK për pezullimin e certifikatës së biznesit të shoqërive tregtare për çfarë ju referua nenit 9 par. 1 të LSHT-së, lidhur me këtë ARBK përkatësisht Drejtori i Përgjithshëm ka kompetenca drejtuese për rregullimin e procesit të regjistrimit të Shoqërive Tregtare dhe ka për detyrë të bëjë regjistrimin e shoqërive tregtare ndërsa Drejtori i Përgjithshëm i ARBK nuk mund të vendosë kërkesa, kushte ose kufizime që nuk janë përcaktuar shprehimisht në LSHT, andaj Dhoma e Shkallës së Parë me të drejtë ka konstatuar se Drejtori i Përgjithshëm i ARBK-së nuk ka kompetenca në marrjen e vendimeve për pezullimin e certifikatave të bizneseve e që për pasojë kanë humbjen e efektit juridik të regjistrimit të paditësit në ARKB, në atë mënyrë që paditësi nuk do të mund të ushtronte as veprimtari ekonomike, kjo në kuptim të nenit 4 të LSHT-së i cili përcakton se: “Veprimtaria Ekonomike në Kosovë mund të ushtrohet vetëm nga Shoqëritë Tregtare të regjistruara në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve, përveç nëse është përcaktuar shprehimisht ndryshe me ligj”. Kolegji vlerëson të drejtë këtë qëndrim juridik të dhënë në aktgjykimin e ankimuar, për faktin se vendimi është marrë duke respektuar dispozitat ligjore dhe procedurale të parapara me Ligjin Ligjit Nr. 06/L -016 për Shoqëritë Tregtare (LSHT) të aplikueshme në Republikën e Kosovës, Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore se Gjykata e Shkallës së Parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale, pasi që me rastin e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, nuk mund të bëhet zbatimi i drejtë i së drejtës materiale. Këto pretendime ankimore kolegji i vlerësoj si të pa bazuara, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga Dhoma e Shkallës së Parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i Dhomës së Shkallës së Parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, andaj, ankesa e paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se Dhoma e Shkallës së Parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadiës së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të

përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Dhoma e Shkallës së Dytë i ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, nuk ka gjetur se ekziston ndonjë shkelje e cila do të ndikonte që vendimi të kualifikohet si i tillë për çka çështja pastaj do të duhej të kthehej në rishqyrtim apo të vendoset ndryshe.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

**Dhoma e Shkallës së Dytë**

**K.DH.SH.II.nr.966/24, me datë 08.10.2024**

**Kryetar i kolegjit,  
Faton Bajrami**